



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:205477
Datë: 14.08.2024
Numri i dokumentit: 06051657

P.nr. 700/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me procesmbajtësen Fatmire Sermaxhaj në lëndën penale kundër të pandehurit S.Z...nga Gj..., për shkak të veprës penale **Vjedhja e shërbimeve**, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1417/2023, të datës 27.09.2023, dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.1417/2023, të datës 27.09.2023 më datë 14.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: S.Z...nga babai A..., me vendbanim në Gj..., rr. " ... "p.n., me numër personal I..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse nga data e pa përcaktuar, deri më datë 05.04.2023, në shtëpinë e tij në Gjilan, në rrugën "...", gjatë inspektimit nga punëtorët e autorizuar të ujsjellësit në Gjilan KRU "Hidromorava", është konstatuar se, i pandehuri S.Z..., si shfrytëzues i ujit të pijshëm, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e shërbimeve në emër të ujit të pijshëm, ashtu që, është kyçur në mënyrë ilegale, në kundërshtim me nenin 7 pika 3 nën pika 3.6 lidhur me nenin 9 të Rregullorës numër 3/2017, për Procedurat e Ndërprerjes së Ujit të KRU "Hidromorava", dhe në këtë mënyrë e keqpërdorur ujin e pijshëm, me çka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzimeve të ujit të pijshëm dhe ka shmangur pagesën, duke e dëmtuar të dëmtuarën KRUK "Hidromorava" në Gjilan, në vlerë të pa caktuar.

-me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38,40, 43,45, 69 të KPRK-s, si dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

I.Të pandehurit S.Z..., për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 100 (njëqindë) euro, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€ (njëzet euro) ndërsa, nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

V. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit S.Z...nga Gjiilani, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjiilan, ka paraqitur kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit S.Z...nga Gjiilani dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet: Procesverbali mbi inspektimin –verifikimin e bërë 000812, i datës 05.04.2023, Kontrata e shërbimeve të ujit, procesverbali me numër 000660, i datë 06.07.2023, Raporti mbi anksën si dhe fotot nga vendi i ngjarjes mbi keqpqrdorimin e ujit.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK-s.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP-s, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.700/2023, Më 14.08.2024

Procesmbajtësja
Fatmire Sermaxhaj

Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.